



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 3386 Prot.

Patos më, 06/09/2024



Miratohet  
Kryetari  
Fation Duro

PROJEKT-VENDIM

Nr. 69, datë 06.09.2024

**“MBI MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TË FONDIT MIDIS PROGRAMEVE PËR  
SHTIM FINANCIMI TË KUZ NË TERRITORIN E BASHKISË”**

Në zbatim të shkronjës dh neni 54, të ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 45, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 44, pika a, Vendimit të Keshillit Bashkiak nr. 81, date 18.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit të vitit 2024”, me miratim prefekturë nr. 1303/1 datë 03.01.2024, analiza dhe rishqyrtimi i projekteve për investime nga Drejtuesit e Programeve, ekipi i menaxhimit pasi verifikoi gjendjen aktuale në terren dhe bëri vlerësimin për ndërhyrje, paraqet në Këshillin Bashkiak projekt-vendimin dhe

**KËRKON:**

1. Të miratojë transferimin e fondit midis programeve për shtim financimi të vlerës 2,557,006 lekë në investimin e rjetit të KUZ si më poshtë:
  - Shtohet programi **06370** llog. 231 vlera 2,557,006 lekë Objekti “Blerje materiale për KUZ”.
  - Pakësohet programi **04520** llog. 231 vlera 2,557,006 lekë Objekti “Ndërtim mure mbajtëse në qytet dhe rrethina”, (Çlirim fondi).

**EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT**

Boreta Murati

Gazmira Plesati

Silvana Mici

Alfred Gremi

Eljano Kumaraku

Juriste: Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

Nr. 3386 Prot.

Patos, më 06/09 /2024

**RELACION**

**Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve për shtim financimi të kuz në territorin e Bashkisë Patos**

**Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Një nga problematikat e vazhdueshme në qytet dhe në lagje të qytetit është sistemimi i ujërave të zeza të cilat janë të disiplinuar deri në një pikë të caktuar dhe më pas vazhdojnë në rrjedhje të lirë për t'u shkarkuar në pikën përfundimtare. Nisur nga kjo problematikë të cilat janë evidentuar dhe në terren për ndërhyrje dhe një pjesë e tyre janë emergjente pasi kalojnë në zonë të banuar dhe përbën problem për banorët në afërsi duke qënë shkak i sëmundjeve të ndryshme dhe përhapjes së tyre.

Është menduar ndërhyrja për sistemimin e ujërave të zeza në :

- 1- Në fshatin Dukas Breg – Është menduar ndërhyrja në këtë segment pasi ujërat e zeza dhe të bardha shkarkohen në rrugë. Për këtë arsye do të vendosen tubo të brinjëzuara HDPE me  $d=200$  mm dhe do të bëhet shkarkimi i tyre në pusëtën e pozicionuar në rrugën kryesore në gjatësi 200 ml. Ndërtimi i pusëtave të kontrollit me dimensione  $1*1*1$  m sipas kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit.
- 2- Në fshatin Kuqar – Në këtë segment është menduar ndërhyrja pasi ujërat e zeza shkarkohen në sipërfaqe të hapur dhe zona është kryesisht e banuar. Shkarkimi i ujërave të zeza është menduar të bëhet në përrua dhe për këtë nevojiten tubo të brinjëzuara HDPE me  $d=315$  mm me gjatësi 200 ml.
- 3- Në fshatin Margëlliç – Është menduar ndërhyrja në 4 segmente si:
  - a. Segmenti me gjatësi 60 ml ku bëhet derdhja në gjendje të lirë në afërsi të zonës së banuar (tek Astriti), për disiplinimin është menduar ndërhyrja me tubo të brinjëzuara HDPE me  $d=200$ mm dhe derdhja e tyre do të bëhen në kanal in e rrugës nga ku do bëhet bashkimi me ujërat e bardha sipërfaqësore dhe do të mundësojnë po ashtu largimin e tyre për në pusëtën qëndrore të kuz.
  - b. Vazhdim i kuz në rrugën e Lapidarit, do të bëhet ndërhyrja me tubo të brinjëzuara HDPE  $d=200$ mm, për lidhje të reja të objekteve të pozicionuara në kuotë me të ulët se kuota e projektit, derdhja e tyre do të bëhet në pusëtën kryesore që vazhdon derdhjen në përrua.
  - c. Është menduar rikonstruksioni i pusëtave ekzistuese (tek Rrapushi) dhe shtim i linjës së kuz me gjatësi 30 ml për derdhjen e ujërave në destinacionin final.
  - d. Vazhdim linje kuz (tek Hamzai), është menduar ndërhyrja në këtë segment pasi është e pozicionuar puseta kryesore dhe bëhet grumbullimi i gjithë ujërave të zeza



të zonës së banuar, derdhja e këtyre ujërave do të bëhet në përrua, për këtë nevojiten tubo të brinjëzuara HDPE d= 200 me gjatësi 200 ml.

- 4- Në lagjen Mustafa Matohiti – Për shkak të formacionit të paqëndrueshëm të tokës janë dëmtuar pusetat ekzistuese, për këtë arsye është menduar ndërhyrja në riparimin e pusetave ekzistuese dhe shtim i linjës së kuz me tubo betoni d=600mm për derdhjen e tyre në destinacionin final (në përrua).
  - 5- Lagjja e Re, Vresht – Zgjatim rrjeti kuz dhe largim i ujërave të zeza nga zona e banuar për tek puseta kryesore e cila bën derdhjen përfundimtare në përrua. Për këtë ndërhyrje nevojiten tubo të brinjëzuara HDPE me d= 315mm me gjatësi L=300ml.
  - 6- Ndërtim rrjeti kuz në lagjen e Re përballë Pëllumb Bença, me gjatësi L=250ml, me tubo të brinjëzuara HDPE d=200mm, shakrkimi do bëhet në përrua.
  - 7- Vazhdim rrjeti kuz në lagjen e Re tek Zeniu, largimi i ujërave nga zona e banuar me gjatësi L=200ml, me tubo të brinjëzuara HDPE d=315mm.
  - 8- Lagja Mustafa Matohiti – Ndërtim rrjeti i ri kuz në rrugën e Ofiçinës për largimin e ujërave të zeza me gjatësi L=36 ml, me tubo të brinjëzuara d=200mm, nga zonat e banuara pasi derdhja aktualisht bëhet në kanalin anës rrugës dhe përbën shkak i sëmundjeve të ndryshme dhe përhapjes së tyre.
  - 9- Fshati Rrerës – Largimi i ujërave të zeza nga zonat e banuara dhe derdhja e tyre në përrua , segmenti është me gjatës 160 ml dhe tubo të brinjëzuara HDPE d=315mm.
- Vlera e projektit do të sigurohet nga çlirimi i fondit nga objekti “Ndërtim mure mbajtës në qytet dhe rrethina” në vlerën prej 2,557,006 lekë me tvsh.
  - Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit dhe Drejtoria e Financës.

#### **Ekipi Menaxhimit të programit:**

Boreta Murati  
**Drejtues i Programit**

Eljano Kumaraku  
**Anëtar**

Gazmira Plesati  
**Anëtar**

Alfred Grëmi  
**Anëtar**

Silvana Mici  
**Anëtar**

**MIRATOI  
KRYETAR  
Fation Duro**





REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI

Fation Duro

PREVENTIV

**Objekti: Blerje materiale per KUZ**

Nr		Emertimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Cimento 32.5 N	kg	11,750.0	10	117,500
2	An	Kallep derrase (10x2.5x400)cm	m3	1.4	27,000	37,800
3	An	Tuba betoni Ø 600 mm	ml	30.0	2330	69,900
4	An	Rere e lare lavatrice	m3	1.8	1546	2,783
5	An	Zhavor lumi	m3	11.8	1417	16,780
6	An	Zall lavatrice	m3	41.0	835	34,235
7	An	Tuba te brinjezuar HDPE d=315 mm	ml	1,098.0	1100	1,207,800
8	An	Rakorderi HDPE d=315 mm	cope	110.0	850	93,500
9	An	Rere lumi	m3	300.0	1055	316,474
10	Treg	Tuba te brinjezuar HDPE d=200 mm	ml	720.0	500	360,000
11	Treg	Rakorderi HDPE d=200 mm	cope	72.0	220	15,840
12	Treg	Tuba te brinjezuar HDPE d=160 mm	ml	60.0	400	24,000
13	Treg	Rakorderi HDPE d=160 mm	cope	6.0	170	1,020
14	An	Hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm2	kg	160	107	17,120
15	An	Kapak pusete gize Ø60	cope	3.0	17,640	52,920
16	An	Kapak zgare celiku 45x45 cm	cope	15	3,500.00	52,500
17	Treg	Kapak pusete gize 90x90 cm		2	22,000	44,000
<b>SHUMA</b>						<b>2,464,172</b>
<b>TVSH 20%</b>						<b>492,834</b>
<b>TOTALI</b>						<b>2,957,006</b>

Hartoi: Ing. Gazmira Plesati

Miratoi: Dr. Boreta Murati